



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, 63.11, 101.2, 102.2 dhe 102.3 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe në përputhje me vendimin e KQZ-së të datës 29.09.2009 për zbatimin e projektit të SMS-ve lidhur me rezultatet preliminare të zgjedhjeve lokale të 15 nëntorit 2009, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 11.11.2009 nxjerr këtë:

VENDIM

Për mënyrën e përpilimit të rezultateve preliminare të Zgjedhjeve Lokale të 15 nëntorit 2009

- I. Përmes këtij vendimi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miraton mënyrën e përpilimit të rezultateve preliminare të Zgjedhjeve Lokale të 15 nëntorit 2009 përmes SMS-ve *si në vijim*:
 - a) *Rezultatet për Kryetar Komune nga secili Vendvotim dhe sipas komunave;*
 - b) *Rezultatet për Kuvendet Komunale për secilin Subjekt Politik sipas Vendvotimeve, sipas komunave dhe në nivel të Kosovës;*
- II. Rezultatet Preliminare të Zgjedhjeve Lokale të 15 nëntorit 2009 si në pikën I të këtij vendimi, KQZ-ja do t'i bëjë publike në afatin e përcaktuar paraprakisht.
- III. Zbatues i këtij vendimi është Sekretariati i KQZ-së.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me 11 nëntor 2009.

Prishtinë, 11.11.2009

Nesrin Lushta

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve